

REPUBLIKA E KOSOVËS			
KOMUNA GLLOGOC			
GLLOGOC MUNICIPALITY			
Priturat		09/12	2020
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01-	400/01-	53531	



Komuna Drenas



Shoqata Bamirëse "Jetimat e Ballkanit"

MARRËVESHJE BASHKËFINANCIMI

NË MES TË

- I. **Komunës së Drenasit**, Rr. "Fehmi Lladrovci"-Drenas përfaqësuar nga Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, (në tekstin e mëtejme Komuna), dhe
- II. **Shoqata Bamirëse "Jetimat e Ballkanit"**, Rr. "Bekim Muhaxhiri" nr.18, Prizren, përfaqësuar nga Drejtori i Shoqatës z. Berat Kabashi, (në tekstin e mëtejme Shoqata)

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj marrëveshje është pajtueshmëria rreth bashkëfinancimit dhe angazhimit të ndërsjellë të palëve të kësaj marrëveshjeje për realizimin e projektit për ndërtimin e 24 (njëzetekatër) shtëpive për familjet skamnore të Komunës së Drenasit, si njëri ndër prioritetet e Komunës dhe si një nga qëllimet kryesore të Shoqatës, për zgjidhjen e problemit të strehimit për familjet skamnore.

Neni 2

Pajtueshmëria rreth procesit

- 2.1. Në përputhje me kushtet e kësaj marrëveshjeje, duke iu përmbajtur kompetencave të përcaktuara ligjore, palët pajtohen që të promovojnë bashkëpunimin dhe asistojnë njëra tjetrën duke dhënë mbështetje profesionale, logjistike dhe asistencë financiare rreth implementimit të procesit të projektit të përbashkët që është paraparë në këtë marrëveshje.
- 2.2. Palët pajtohen që përzgjedhjen e familjeve në nevojë si përfituese të ndërtimit të shtëpive ta bëjë Komisioni profesional Komunal i formuar me Vendim të Kryetarit të Komunës së Drenasit, në pajtim me përfaqësuesin e Shoqatës.

- 2.3. Palët pajtohen që përzgjedhjen e kompanisë punëkryese për ndërtimin e 24 shtëpive do ta bëjë Shoqata “Jetimat e Ballkanit”, e cila do t’ia dorëzojë Komunës një kopje të marrëveshjes që përfshinë çmimin e përcaktuar për ndërtimin e 1 (një) shtëpie.
- 2.4. Palët pajtohen që Komisionin mbi pranimin e punëve të kryera ta formojë Kryetari i Komunës në pajtim me përfaqësuesin e Shoqatës.

Neni 3

Obligimet e Komunës së Drenasit

- 3.1. Komuna obligohet që të participojë me mjete financiare në shume totale prej 118,000.00€ (tetëdhjetëmijë mijë euro), (për 24 shtëpi banimi, ku participimi i Komunës do të jete 5,000.00€ për shtëpi), mjete të cilat do të transferohen në llogarinë bankare të Shoqatës Bamirëse “Jetimat e Ballkanit” me nr.XKO51110318280000140 - PROCREDIT BANK.
- 3.2. Pagesa e mjeteve do të bëhet pas nënshkrimit të kësaj marrëveshje dhe të marrjes së obligimeve reciproke dhe ligjore.
- 3.3. Komuna obligohet që të plotësojë deklaratën e disponueshmerisë së mjeteve për projektin nga neni 1 i kësaj marrëveshje.
- 3.4. Komuna do të caktojë një organ mbikëqyrës për përcjelljen dhe mbarëvajtjen e procesit të implementimit të projektit nga neni 1 (një) i kësaj marrëveshje.
- 3.5. Komuna obligohet që të krijojë kushte të nevojshme për realizimin e projektit “Ndërtimi i Shtëpive për të Pastrehët në Komunën e Drenasit”, duke siguruar tërë dokumentacionin e nevojshëm që ka në dispozicion si Institucion (pronësinë, lejet ndërtimore, specifikacionin teknik, si dhe çdo dokument tjetër të nevojshëm për këtë projekt).

Neni 4

Obligimet e Shoqatës “Jetimat e Ballkanit”

- 4.1. Shoqata obligohet për ndarjen dhe sigurimin e pjesës tjetër të mjeteve financiare të nevojshme për bashkëfinancim, përkatësisht për finalizimin e ndërtimit të shtëpive në përputhje me nenin 1 të kësaj marrëveshje ku participimi i Komunës së Drenasit për 1 (një) shtëpi do të jetë 5000€ (pesëmijë euro), ndërsa për Shoqatën 15,000 €, përjashtimisht për ndërtimin e shtëpisë së 24 participimi i Komunës do të jetë 3000€ ndërsa i Shoqatës 17,000 €.
- 4.2. Shoqata obligohet që t’i dorëzojë Komunës projektin e detajuar për shtëpitë që do të ndërtohen (duke përfshirë paramasat, dhe koston financiare), si dhe një kopje të kontratës për ndërtimin e shtëpive sipas projektit të dakorduar.

- 4.3. Shoqata obligohet që për çdo ndryshim eventual të sasisë dhe kualitetit gjatë implementimit të projektit ta njoftojë Komunën dhe për këtë të kërkojë pëlqim paraprak.
- 4.4. Shoqata obligohet që organit mbikëqyrës të Komunës nga neni 3.4. i kësaj marrëveshje t'i lejoj qasje pa pengesa në përcjelljen e procesit të implementimit të projektit dhe të njëjtin ta njoftojë rreth rrjedhës së realizimit të projektit deri në përfundim të tërësishëm të tij.
- 4.5. Shoqata merr përsipër çdo punë shtesë eventuale, përfshirë edhe konsekuencat eventuale financiare shtesë.

Neni 5

Dispozitat përfundimtare

- 5.1. Palët duhet të veprojnë me besim të plotë për të siguruar arritjen e të gjitha objektivave të marrëveshjes.
- 5.2. Marrëveshja mund të ndryshohet, plotësohet dhe zgjidhet me mirëkuptim ndërmjet bisedimeve, negocimit, me pëlqim të palëve nënshkruese të saj dhe çdo ndryshim i saj duhet të bëhet në formë të shkruar dhe të nënshkruhet nga të dyja palët dhe të integrohet brenda kësaj marrëveshjeje.
- 5.3. Palët nuk do të marrin përgjegjësi për mos përmbushjen e obligimeve pjesërisht apo plotësisht nëse paraqiten rrethanat e Fuqisë Madhore (Vis Maior).
- 5.4. Mospajtimet eventuale të cilat mund të rrjedhin nga kjo marrëveshje do të rregullohen nga palët në bashkëpunim me njëra-tjetrën, e nëse kjo nuk është e mundur mosmarrëveshjet eventuale duhet zgjidhur nga gjykata kompetente.
- 5.5. Kjo marrëveshje mund të shkëputet nga palët me njoftim paraprak për njëra-tjetrën.

Neni 6

Kopjet dhe hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje është nënshkruar në katër ekzemplare të njëjtë, nga dy për secilën palë nënshkruese dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj.

Komuna e Drenasit

Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës



Nënshkruesit

Shoqata Jetimat e Ballkanit

Berit Kabashin

